



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
NJËSIA E PROKURIMIT**

Kamëz, më ____07.2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje Kancelari”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
30190000-7**

**VLERA E FONDIT LIMIT: 7,883,331 (shtatë milion e tetëqind e tetëdhjetë e tre mijë e
treqind e tridhjetë e një) lekë pa tvsh.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor “**Bashkia Kamëz**” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: *Ky kriter u vendos bazuar ne nenin 82 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 te VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik” i ndryshuar, ne te cilen eshte e percaktuar se: “1. Bashkë me dorëzimin e*

kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.” Ky kriter u vendos sipas nenit 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në të cilin është e parashikuar se: Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël. Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit: a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përllogaritur të kontratës; b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe në nenin 30 të VKM nr.285 date 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: *Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare (2023-2024-2025), ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40%** e vlerës së përllogaritur të lotit që prokurohet .

Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar.*

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomik ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet

dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur e thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

Kjo vlerë është kërkuar duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Kapaciteti teknik dhe profesional:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së perlogaritur të kontratës, të këtij loti. qe prokurohet dhe qe është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës/lotit.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Ne rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik**, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasinë e mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat**, si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasinë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, nenin 40, pika 4, si dhe nenin 55, pika 4 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar, Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e ngjashme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe përvojën e operatorëve ekonomik ofertues në fushën objekt prokurimi, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.*

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë, me anë të së cilës deklaron se artikujt objekt prokurimi do të jenë të reja, të papërdorura më parë dhe pa dëmtime.

Argumentim: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe pika 8 e nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të realizojnë objektin e prokurimit në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike, duke furnizuar mallra cilësorë dhe pa dëmtime estetike apo në strukturë, deri në ambjentet e Aautoritetit Kontraktor përfitues.*

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, të gjithë artikujve në ambjentet e përcaktuara nga Autoritetit Kontraktor sipas kërkesave të përcaktuara në specifikimet teknike të ngarkuara në SPE dhe brenda afatit kohor të përcaktuar.

Argumentimi: *Në bazë të nenit 40 pika 5/ç dhe pika 8 e VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, kërkohet që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se kanë kapacitetet teknike për ekzekutimin e kontratës, pra operatorët ekonomik duhet të vërtetojnë që kanë mjetet e duhura për ushtrimin e veprimtarisë, i cili duhet të funksionojë në bazë të dispozitave ligjore në fuqi duke paraqitur një deklaratë. Kjo kërkesë konsiderohet minimale, e arsyeshme dhe proporcionale me objektin e prokurimit dhe shërben për të garantuar realizimin korrekt dhe në kohë të kontratës.*

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetin dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Automjet Transporti	1 copë	Në pronësi ose me qera

Shenim: *Për mjetin e transportit OE duhet të paraqesë Certifikatën e Pronësisë, Leje Qarkullimi, Kolaudimin, Siguracionin dhe pagesën e taksave.*

Për mjetet me status përdorimi qira/hua përdorje të disponohet kontrata noteriale përkatëse mes qiradhënësit dhe qiramarrësit.

Mjetet e transportit që do të deklarohet detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të genë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shënim: *Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit. Dokumentet e kërkuara me sipër do të paraqiten në rast se operatori kualifikohet i pari, por*

përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentim: *Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” te ndryshuar dhe nenit 40, pika 5/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” te ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet për kryerjen e transportit të mallrave për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Autoriteti kontraktor, duke marrë parasyshë vlerën llojin e objektit të prokurimit për këtë lot, numrin dhe shpërndarjen gjeografike të autoriteteve kontraktore që do të furnizohen e konsideron si një kriter minimal dhe të drejtë kërkesën për një automjet për zbatimin e kontratës.*

2.3.5 Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin mostrat për disa prej artikujve të kerkuar si më poshtë, në ditën e hapjes së ofertave, në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit:

- **Artikulli Nr. 2: Bllok shënimesh A5 me 100 fletë**
- **Artikulli Nr. 8: Dosje Kartoni e Thjeshtë**
- **Artikulli Nr.17: Evidenciator 4 ngjyra**
- **Artikulli Nr.24: Heqese teli e vogel**
- **Artikulli Nr.38: Kuti arkive standard**
- **Artikulli Nr.43: Letër fotokopje, 80gr/m2 A3**
- **Artikulli Nr.44: Letër fotokopje, 80gr/m2 A4**
- **Artikulli Nr.52: Mbajtëse kancelarie për mjete**
- **Artikulli Nr.53: Mbajtëse plastike dokumentesh horizontale me 3 kate**
- **Artikulli Nr.65: Stilolaps me xhel blu**
- **Artikulli Nr.69: USB 3.0, 32GB**
- **Artikulli Nr.72: USB Flash Drive 16 GB 3.0**
- **Artikulli Nr.75: Zarfa 23 x 33 cm (A4)**

Shënim: Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht s’kualifikimi për vazhdimin e procedurës.

- Mostrat e kërkuara duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë: mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.

- Mostrat duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.

-Mostrat do të dorëzohen përpara komisionit, në orën dhe datën e percaktuar për hapjen e ofertave, pranë Bashkisë Kamëz.

Argumentimi: Referuar VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik” neni 40 pika 6 është përcaktuar se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Artikujt për te cilet kerkohen mostra janë me rëndësi për të verifikuar cilësinë dhe kompatibilitetin e produkteve të ofruara.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë certifikata të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit, si më poshtë:

- **ISO 9001:2015** “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalent (e vlefshme);

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, nenit 44, të VKM-së nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë certifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të certifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

ARGUMENTIMI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet teknike, për mallin objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit të 36, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar si dhe nenit 15, pika 3/b dhe nenit 40, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

Specifikimet teknike dhe fondi limit janë hartuar nga komisioni i ngritur me Urdhrin **Nr.7078/1, Datë 26.06.2026** të Titullari të Autoritetit Kontraktor, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe referuar nevojave specifike të vetë AK për artikujt objekt prokurimi.

Grupi i punës për përlllogaritjen e fondit limit ka marrë parasysh çmimet e tregut, mbështetur në nenin 76 gërma ”b” e VKM-së nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti/enti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura, si më poshtë vijon: ... b) studimit të tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim...”*.

NJËSIA E PROKURIMIT: